



## I. ANALIZA LIGJORE DHE JURIDIKE NË LIDHJE ME ELEMENTE SPECIFIKE RISI TË PROJEKTLIGJIT TË RI

1. Planifikimi familjar / sterilizimi (Neni 10).
2. Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë (Neni 12, pika 4).
3. Teknikat e riprodhimit të asistuar (Neni 15/18/19)
4. Përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar (Neni 19).
5. Shtatzënia surrogative (Neni 22).
6. Birësimi surrogativ - parashikim referues në Kodin e Familjes për birësimin surrogativ, (Neni 22, pika 6.)

Konkretisht:

### 1. Planifikimi familjar /sterilizimi (Neni 10)

**Parashikim:** *Sterilizimi kirurgjikal është parashikuar si metodë për planifikimin familjar dhe kryhet vetëm kur pacienti jep pëlqimin me shkrim dhe kur plotëson kriterin moshë të parashikuar në të njëjtin nen (18 vjeç për femrat dhe 23 për meshkujt, nën këtë moshë nevojitet leje nga Komisioni për Vlerësim Mjekësor).*

**Oponencë:** Sterilizimi, si metodë kontraceptive për të rriturit, edhe pse parashikohet në shumicën e vendeve të zhvilluara, në kontekstin shqiptar bie ndesh me parimet e përgjithshme të mbrojtjes së jetës dhe të familjes.

Për më tepër, sterilizimi i të miturit është i ndaluar (p.sh. legjislacioni francez parashikon ndalimin e sterilizimit të të miturit. Madje, edhe sterilizimi i personave me aftësi ndryshe vendoset me vendim gjyqësor, pas kërkesës së prindërve dhe mendimit të komisionit rajonal shëndetësor.)

Për shoqërinë shqiptare, kjo metodë, e pashoqëruar me garancitë e duhura ligjore përkundrejt abuzimit, nuk krijon besueshmëri që do t'i shërbejë qëllimit të planifikimit familjar.

Projektligji parashikon një vullnet të individit për sterilizim kirurgjikal, por ndërkohë nuk parashikohet se si do të shprehet ky vullnet; se si do të mbrohet individi nga vullneti i vesuar; se si vullneti i një individi nën moshën e caktuar t'i besohet një komisioni të zakonshëm dhe njëkohësisht të papërcaktuar në drejtim të përzgjedhjes së anëtarëve; apo edhe nëse do të jenë të spitalit shtetëror, apo privat. Kjo e fundit krijon një rrezik të shtuar në drejtim të abuzimit me këtë të drejtë që i jepet një individi, apo një klinike a spitali privat.

Sterilizimi i detyruar, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, bie ndesh me të drejtat e parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

### 2. Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë (neni 12, pika 4)

**Parashikimi:** *Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë mund të kryhet brenda 14 javëve të para të shtatzënisë, me kërkesë të gruas shtatzënë dhe duhet të plotësojë disa kushte të parashikuara në këtë nen.*



**Oponencë:** Në këndvështrimin ligjor janë të rralla shtetet që në legjislacioni e tyre dënojnë ndërprerjen vullnetare të shtatzënisë. Ndërsa në aspektin etik, moral dhe fetar ne shprehim qëndrimin tonë kundër abortit dhe pro jetës, përveç rasteve kur vihet në rrezik shëndeti i nënës.

### **3. Teknikat e riprodhimit të asistuar (neni 15/18/19)**

**Parashikimi:** Neni, 15, pika 1: “teknikat e riprodhimit të asistuar janë procedura që kanë për qëllim të rregullojnë nevojat e një individi ose të një çifti” ; pika 3: Përdorues të këtyre teknikave do të jenë çiftet heterologe të martuara ose që bashkëjetojnë, si dhe gruaja pa partner.

Neni 18, pika 6: **Dhurimi i qelizave riprodhuese ose embrione**

Numri maksimal i autorizuar për fëmijë të lindur në Shqipëri, që gjenerohen me qeliza riprodhuese të të njëjtit dhurues, si për dhuruesin e spermatozoideve, ashtu edhe për dhuruesen e vezëve, nuk duhet të jetë më i lartë se 5 (pesë). Në raste të veçanta, mund të bëhen përjashtime, kur gruaja ose çifti kërkon një fëmijë të dytë ose të tretë nga i/e njëjti/njëjta dhurues/dhuruese.

Neni 19 **Përdoruesit e teknikave**

1. E drejta për riprodhim mjekësor të asistuar, përfshin të drejtën e riprodhimit për çiftet heteroseksuale dhe gruas pa partner.

4. Gruaja mund të jetë përfituese apo përdoruese e teknikave të rregulluara në këtë ligj pavarësisht gjendjes së saj civile.

**Oponencë:** Shkelje e Kodit të Familjes, ku termi “grua pa partner” nuk parashikohet në asnjë dispozitë të Kodit të Familjes. Ky term i ri mund të shtyjë edhe fertilizimin nga një çift i të njëjtës gjini, por le vend edhe hapësirë për trafikim qeniesh njerëzore, shkelje e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, e drejta e jetës dhe të drejtat e fëmijëve.

Gjithashtu, përfshirja në të njëjtën dispozitë, Neni 15, pika 1 e termit “individ”, si dhe e parashikimit të “gruas përfituese pavarësisht gjendjes civile” në Nenin 19 pika 4, janë në kundërshtim me Kodin e Familjes. Në këtë kod nuk përfshihen terma të tilla kur bëhet fjalë për fëmijën, të drejtat që shoqërojnë atë që nga lindja. Në Nenin 5 të Kodit të Familjes parashikohet shprehimisht se: “Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar ...”

Po kështu, lidhur me termin “individ” në nenin në pikën 1 të Nenit 15, ku parashikohet se teknikat e riprodhimit të asistuar janë procedura që kanë për qëllim të rregullojnë nevojat e një individi ose të një çifti, konstatohet se nëpërmjet këtij parashikimi tashmë shtohet edhe një subjekt tjetër, përveç “gruas pa partner” të sipërpërmendur: atij të një individi të papërcaktuar, duke lënë shteg edhe për një person jo të gjinisë femërore?.

### **4. “Përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar”**

**Parashikimi:** Neni 19 parashikon në pikën 2: “Riprodhimi mjekësor i asistuar, mund të ndodhë edhe kur ka një marrëveshje midis një gruaje që mbart mitrën e saj dhe lind një fëmijë për një grua tjetër, e cila e ka të pamundur të lindë fëmijë”.

**Oponencë:** Huazimi i mitrës është i ndaluar në shumë vende të zhvilluara evropiane (Francë, Belgjikë, Gjermani, etj.). Parashikimi i këtij projektligji cenon respektin e trupit njerëzor, dinjitetin e gruas dhe të fëmijës.



## 5. Shtatzënia surrogative (Neni 22)

Parashikimi: “ 1. Shtatzënia surrogative bëhet në bazë të një marrëveshje me shkrim midis gruas që dëshiron të ketë një fëmijë, por që ndodhet në kushtet e pamundësisë mjekësore, dhe gruas që do të bartë fetusin në mitrën e saj dhe do të lindë fëmijën për llogari të së parës. 2. Gruaja që dëshiron të ketë një fëmijë, duhet të jetë infertile ose ta ketë të pamundur të ketë një shtatzëni në trupin e saj për arsye anatomike, mjekësore ose të një risku të lartë për shëndetin e saj, në rast se mbetet shtatzënë. 3. Gruaja zëvendësuese (surrogate) nuk duhet të përdorë vezët e saj për arritjen e shtatzënisë. 4. Nëna surrogate duhet të jetë mbi 25 vjeç dhe të ketë lindur të paktën një fëmijë. 5. Procedurat dhe kushtet që duhen plotësuar për një shtatzëni surrogate, përcaktohen në protokollin përkatës të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”

**Oponencë:** Ky nen paraqet vullnetin e propozuesve të projektligjit për t'i hapur rrugën mundësive të shumta të abuzimit me femrën dhe dinjitetin e saj, si dhe mosgarantimit të drejtave të fëmijës. Përdorimi i termit “surrogative” në vend të “zëvendësuese” duket i qëllimshëm, për shmangien e ndërgjegjësimit të opinionit publik për kuptimin dhe rreziqet që paraqet iniciativa e ligjit. Për më tepër “shfrytëzimi i mëmësisë zëvendësuese” është konsideruar si akt Kriminal nga Parlamenti Evropian në Direktivën respektive kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave.

## 6. Birësimi surrogativ (Neni 22, pika 6)

Parashikimi: Pika 6 e Nenit 22 përbën një parashikim referues në Kodin e Familjes për birësimin surrogativ, Neni 261, i cili parashikon: “Për birësimin surrogativ, të parashikuar në ligjin nr. 8876, datë 4.4.2002 “Për shëndetin riprodhues”, zbatohen të njëjtat kriteret dhe procedura për birësimin, sipas këtij Kodi dhe legjislacionit përkatës”.

**Oponencë:** dispozita referuese në rastin konkret duhet të kundërshtohen me forcë pasi paqartësia dhe mosparashikimi i shumë detajeve nëpër nenet konkrete, përfshirë edhe pikën 6 të nenit 22 të projektligjit, lënë shteg për abuzime me birësimin dhe cenojnë drejtpërdrejt të drejtat dhe interesin më të lartë të fëmijës.

### Disa argumente që ky projektligj bie ndesh dhe cenon

1. Të drejtën e jetës, dinjitetit njerëzor dhe lirisë.
  - a. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, nga e cila burojnë të gjithë kartat dhe protokollet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në preambolo dhe në Nenin 1, 2 dhe 3 të deklaratës (DUDNJ).
2. Shkelen direktivat dhe normat e Bashkimit Evropian, ku Shqipëria aderon dhe ka detyrim t'i zbatojë.
3. Mbi surrogacinë (Referuar ligjit, qëndrimeve dhe argumenteve të BE-së).
  - a. “Trafikimi njerëzor është një akt kriminal që ka një kosto të lartë njerëzore.” - u shpreh Ministri i Drejtësisë së Belgjikës, i cili është ndër figurat që analizoi fenomenin e surrogacisë në arenën evropiane.



4. Duke u nisur nga qëndrimet dhe qasja e BE- së, Parlamenti Evropian e shpalli surrogacinë një "krim të ri", duke e përfshirë në Direktivën kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Më 24 prill 2024, Parlamenti Evropian votoi unanimit me 563 vota pro, 7 kundër dhe 17 abstenim, duke e konsideruar surrogacinë zyrtarisht një formë të trafikimit njerëzor (krim evropian).
5. Shtetet evropiane në përgjithësi e ndalojnë surrogacinë pasi konstatojnë shkeljen e dinjitetit të fëmijës dhe nënës surrogate. Pasojat gjenetike dhe emocionale të surrogacisë për fëmijët, prindërit dhe brezat e ardhshëm përbëjnë një kërcënim për familjen, e cila është bërthama e shoqërisë sonë. Fëmija është një dhuratë nga Zoti dhe jo një objekt që, për të përmbushur dëshirat dhe egoizmin e të rriturve, materializohet në industrinë e surrogacisë.
6. Komercializimi i riprodhimit, ku të pasurit mund të blejnë fëmijë, përbën një aspekt shqetësues dhe përkeqësues për shoqërinë. Jetëzimi i surrogacisë mund të transformojë konceptin e riprodhimit nga një eksperiencë natyrale dhe personale, në një akt shit-blerjeje sipas nevojës. "Shërbimet" e riprodhimit do të blihen nga personat me kushte më të mira financiare.
7. Aspekti financiar mund të krijojë probleme etike dhe të shfrytëzimit të grave nga shtresa më e varfër, të cilat mund të detyrohen të bëhen nëna surrogate vetëm për arsye financiare dhe jo me vullnetin e tyre të lirë.
8. Ekzistojnë disa anë negative për barazinë gjinore, të cilat sjellin pasoja negative në situatat ndërkombëtare. Praktika e surrogacisë ka shfaqur problematika për nënat surrogate në Ukrainë që, për shkak të luftës, dëshironin të linin vendin por nuk lejoheshin për shkak se duhet ta lindnin fëmijën në tokën ukrainase.

## II. ASPEKTI SHËNDETËSOR

### **Analiza etike dhe shëndetësore në lidhje me elemente specifike risi e projektligjit të ri**

1. Sterilizimi / Planifikimi familjar (Neni 10).
2. Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë (Neni 12).
3. Përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar (Neni 19)
4. Shtatzënia surrogate (Neni 22)

Konkretisht:

#### **1. Sterilizimi / Planifikimi familjar/sterilizimi (Neni 10)**

Parashikim: *sterilizimi kirurgjikal është parashikuar si metodë për planifikimin familjar dhe kryhet vetëm kur pacienti jep pëlqimin me shkrim dhe kur plotëson kriterin moshë të parashikuar në të njëjtin nen (18 vjeç për femrat dhe 23 për meshkujt, nën këtë moshë nevojitet leje nga Komisioni për Vlerësim Mjekësor).*



**Oponencë:** Sterilizimi, si metodë kontraceptive është një ndërhyrje mjekësore që ndikon në trupin dhe shëndetin e individit për gjatë gjithë jetës. Edhe pse mund të jetë një veprim me pëlqimin e vetë personit, është i pakthyeshëm dhe me pasoja për jetën e tij.

Lehtësimi i një ndërhyrje të tillë bie në kundërshtim me rastet e njerëzve të penduar që e aplikojnë atë, ku mbi 83 % e atyre që kanë kryer sterilizimin pas një kohe kanë shfaqur pendesë dhe, akoma më e rëndë, kur bëhet fjalë për të rinj, vajza 18- vjeçare ose djem 23-vjeçarë, të cilët mund të mos kenë informacionin e mjaftueshëm mbi pasojat dhe parikthyeshmërinë e tij.

## **2. Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë (Neni 12)**

**Parashikimi:** *Ndërprerja vullnetare e shtatzënisë mund të kryhet brenda 14 javëve të para të shtatzënisë, me kërkesë të gruas shtatzënë dhe duhet të plotësojë disa kushte të parashikuara në këtë nen.*

**Oponencë:** Bazuar në studimet dhe hulumtimet më të rëndësishme embrioni njerëzor që nga java e 6-të e gravidancës fillon të zhvillohet me diferencimin e organeve jetësore dhe formimin e shenjave të ndryshme identifikuese, duke arritur një diferencim të dukshëm në javën 13-14 të gravidancës ku, me përdorimin e teknologjisë dhe metodave gjenetike, mund të arrihet të përcaktohet edhe gjinia e fetusit.

Në Shqipëri janë realizuar rreth 30.000 aborte në 5 vitet e fundit, rreth 220 aborte për 1.000 lindje, - një përqindje tejet e lartë.

Aktualisht sot jemi në nivelin e lindshmërisë 1.4 fëmijë për grua, ndërkohë që niveli i mbijetesës së shoqërisë është minimalisht 2.1.

Pra zgjidhja nuk është të stimulojmë abortin, (një mjet vrastar), por të stimulojmë lindshmërinë me më shumë masa sociale, ekonomike, edukative, shëndetësore etj.

Nga ana tjetër “aborti selektiv” është vrasësi më i madh i fetusit të seksit femër, pra bie ndesh direkt me të drejtat e grave.

Nga viti 1990 deri më sot nëpërmjet “abortit selektiv” të jashtëligjshëm - në vendin tonë janë vrarë 33.000 fetuse femërore, mbas përcaktimit të seksit intrauterin. Kjo ka bërë që në Shqipëri të kemi një raport mashkull/femër 112/100 nga 105/100 që është normaliteti i shoqërisë.

Ligjërimi i abortit deri në javën e 14-të:

- Prek fetusin në një periudhë të rëndësishme të formimit dhe zhvillimit si genie njerëzore edhe nga ana biologjike.
- Ligjëron abortet selektive me bazë gjinore duke i vrarë ato.
- Shton kohëzgjatjen e periudhës së abortit, duke favorizuar incidencën e tij.

Të gjitha këto janë politika jo vetëm kriminale, por dhe krejt ndesh me interesat reale të popullsisë dhe shoqërisë sonë.

Sugjerimi ynë do të ishte jo rritja e moshës së lejuar të abortit, por reduktimi i saj nga 12 javë në 8 javë.



### 3. Përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar (Neni 19)

**Parashikimi:** Neni 19 parashikon në pikën 2: *“Riprodhimi mjekësor i asistuar mund të ndodhë edhe kur ka një marrëveshje midis një gruaje që mbart mitrën e saj dhe lind një fëmijë për një grua tjetër, e cila e ka të pamundur të lindë fëmijë”.*

**Oponencë:** Në këtë praktikë, një grua detyrohet të marrë me qira trupin e dikujt për qëllime riprodhuese, pavarësisht nga motivet që e nxisin atë, qoftë presioni psikologjik apo nevojat ekonomike.

Shtatzënia me kontratë gestacionale kërkon javë të tëra injeksionesh hormonale, si dhe teste të pakëndshme për të vlerësuar bllokimin e mundshëm në tubat fallopiane dhe procedurën ndonjëherë shumë të dhimbshme të transferimit të embrionit.

Kjo procedurë mund të shoqërohet me efekte anësore, si dëmtim i përkohshëm apo i përhershëm i shëndetit riprodhues të gruas që i nënshtrohet.

### 4. Shtatzënia surrogative dhe teknikat e riprodhimit të asistuar (Nenet 15, 18, 19, 22)

**Parashikimi:** *“1. Shtatzënia surrogative bëhet në bazë të një marrëveshje me shkrim midis gruas që dëshiron të ketë një fëmijë, por që ndodhet në kushtet e pamundësisë mjekësore, dhe gruas që do të bartë fetusin në mitrën e saj dhe do të lindë fëmijën për llogari të së parës. 2. Gruaja që dëshiron të ketë një fëmijë, duhet të jetë infertile ose ta ketë të pamundur të ketë një shtatzëni në trupin e saj për arsye anatomike, mjekësore ose të një risku të lartë për shëndetin e saj, në rast se mbetet shtatzënë. 3. Gruaja zëvendësuese (surrogate) nuk duhet të përdorë vezët e saj për arritjen e shtatzënisë. 4. Nëna surrogate duhet të jetë mbi 25 vjeç dhe të ketë lindur të paktën një fëmijë. 5. Procedurat dhe kushtet që duhen plotësuar për një shtatzëni surrogate, përcaktohen në protokollin përkatës të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”*

**Oponencë:** Surrogatia është një nga procedurat mjekësore, që më shumë se çdo gjë tjetër vë përballë dinjitetin njerëzor me paranë që fitohet për shkak të “mëditjes” së punës riprodhuese të grave.

Bazuar në studime dhe hulumtime, lidhja fëmijë - nënë fillon që në jetën intrauterine. Fëmija, që nga muaji i 3-të i gravidancës, fillon dialogun sensorial me nënën, duke u bërë fëmijë i asaj nëne, pavarësisht nga lidhja gjenetike.

Fëmija fillon të dallojë zërin e nënës, rrahjet kardiake, ambientohet edhe me shijet ushqimore të nënës nëpërmjet qarkullimit të lëngut amniotik, njeh aromën e nënës etj.

Po kështu edhe sistemi imunitar i fëmijës plotësohet e pasurohet gjatë gravidancës nga nëna që e mban në uterus, duke krijuar një lidhje imunitare të përbashkët.

Në fakt që nga muaji i 6-të i gravidancës fetusi merr pjesë aktive në jetën e nënës, pra midis të dyve krijohet një lidhje e fortë, që vazhdon edhe pas lindjes.

Pika e kontaktit të fëmijës me ambientin direkt pas lindjes është nëna. Prandaj fëmija i porsalindur i jepet në krah menjëherë nënës.

Ndarja, që kërkohet të bëhet në këto raste sipas propozimit ligjor, përveç shumë problemeve të tjera mjekësore, mund të krijojë edhe trauma të forta psikike e psikologjike, si të fëmijës, ashtu dhe të nënës që e mban në uterus.



Pra këtu problemet nuk janë vetëm etike e morale, por edhe thellësisht biologjike, mjekësore dhe gjenetike.

Aplikimi i këtij ligji do të shërbejë kryesisht për të kthyer vendin tonë në një “fermë” fetusesh e trafikimesh ndërkombëtare të riprodhimit nën drejtimin e grupeve të ndryshme kriminale kombëtare e ndërkombëtare.

Po ashtu, rrit mundësinë për disa çifte që të kërkojnë një “fëmijë dizajner” duke qenë të gatshëm të paguajnë shuma të mëdha për konceptimin e këtyre embrioneve.

Sugjerimi ynë do të ishte ndalimi i plotë i surrogatisë në Shqipëri.

### **III. ASPEKTI SOCIAL DHE ETIK**

Në projektligj është parashikuar “fertilizimi” si një nga teknikat e përdorura për arritjen e një shtatzënie. Lidhur me këtë term, duam të theksojmë qëndrimin tonë se teknikat mjekësore që i vijnë në ndihmë një çifti bashkëshortësh për të pasur mundësinë e një shtatzënie duhet të jenë brenda kuadrit të konceptit fëmijë – fryt i marrëdhënies midis gruas dhe burrit bashkëshortë midis tyre, që krijojnë bazën e familjes. Në këtë këndvështrim, është e papranueshme parashikimi i teknikave artificiale të krijimit të fëmijës, - përdorimit të dhuruesve, apo terminologjisë “partner”, “për nevojat e individit” “embrione njerëzore të krijuara” të përdorura në projektligjin në fjalë. Çdo fëmijë ka të drejtën e tij të ketë një nënë dhe baba të njohur-prej tij, e cila nuk mund të garantohet nëpërmjet një ngjizje - artificiale.

Gjithashtu, nën të njëjta konsiderata, quajmë të papranueshme parashikimet e ligjit në fjalë lidhur me krijimin e bankës për ruajtjen e embrioneve, ose qelizave riprodhuese dhe institucionit përkatës ruajtës dhe asgjësues të tyre. Me anë të këtyre parashikimeve, disa njerëz prindër/mjekë vendosin dhe përcaktojnë fatin e njerëzve të tjerë (fëmijës -). Natyrshëm në këtë situatë lind pyetja – kush jemi ne, që vendosim për fatin e tyre nëse do të jetojnë, apo do të vdesin, si do t’i përgjigjemi fëmijëve në rast se për ata vendosim të jetojnë – kur të marrin vesh për vitet e qëndruar në frigorifer dhe mundësinë, që ata edhe mund të mos kishin ardhur në jetë?! Këto përpos qëndrimit fetar, krijojnë çështje etiko-sociale, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në qenien e njeriut në drejtim të tronditjes së marrëdhënieve njerëzore.

Rreziku tjetër i shtuar përse i përket ligjërit të bankës së ruajtjes së embrioneve, apo mundësinë e asgjësimit të tyre lidhet edhe me mundësinë e abuzimit, që mund të ndodhë me këto parashikime në drejtim të trafikimit të qenieve njerëzore, apo organeve.

#### **Perspektiva individualiste e të drejtave**

Duke vërejtur qasjen e përdorur nga projektligji, konstatojmë se të drejtat e përcaktuara aty bazohen mbi një interpretim individualist të subjektivitetit, sikur njeriu të mund të përcaktohej plotësisht, duke u nisur vetëm prej ekzistencës së vet si subjekt individual. Në logjikën e absolutizimit të përmasës individuale (mbështetur edhe nga e drejta për *privacy*, e kuptuar jo si duhet), të drejtat që lidhen me praktikën e ndryshme të parashtruar aty, zhvendosen në sferën private/individuale, me pretendimin gjithashtu për t’i parë ato të njohura dhe të nxitura prej strukturave publike.



### **E drejta për një fëmijë apo të drejtat e fëmijës?**

Projektligji, në nenin 4, pika 1, a, flet për respektimin e “dinjitetit njerëzor”, koncept *themelor* ky, *universal* e *i patjetërsueshëm* i të drejtave njerëzore. Mirëpo, në rastin konkret të fertilizimit të asistuar dhe shtatzënisë surrogate, pyetja që shtrohet është: në cilën mënyrë kjo praktikë respekton dinjitetin njerëzor të fëmijës e të gruas? Nisur nga fakti që ky projektligj synon t’i ligjësojë këto praktika, kuptojmë se interpretimi, që i jepet konceptit “dinjitet njerëzor” në *përmbajtjen* e vet, është i tillë: *është në përputhje me dinjitetin njerëzor që dëshira për të pasur fëmijë të njihet si një e drejtë që duhet mbrojtur me ligj*. Dinjiteti njerëzor, i kuptuar kështu, i hap rrugën praktikave e teknikave që, në mënyrë kontradiktore, ndërsa *duket* se i respektojnë të drejtat njerëzore, mohojnë vetë *qenien njerëzore*, që në *shfaqjen e parë* të saj. Kjo gjë bëhet e qartë kur shohim rrugën që ndiqet për të arritur te amësia surrogate.

Praktika nis me *diagnostikimin para implantimit - DPI* - (neni 24, pika 1), si pjesë e procesit të riprodhimit të asistuar in vitro, që ka për qëllim riprodhimin pas një selektimi gjenetik, që shërben për të rritur përqindjen e suksesit të shtatzënisë. Në këtë rast, nuk bëhet fjalë për shëndetin gjenetik, por për suksesin e shtatzënisë. Kjo praktikë nuk mund të mbështetet nga pikëpamja etike, sepse riprodhon duke seleksionuar, e për pasojë skarton embrionet që, si *qenie njerëzore* prej momentit të ngjizjes (krh. *Përkufizimet*, neni 3, pika 1, shkronja d), kanë të drejtë të jetojnë. Kësisoj, ajo krijon qëllimisht një situatë të vështirë, ku dëshira për të pasur fëmijë shoqërohet me refuzimin këtij të fundit, gjë kjo që përbën një kontradiktë të mirëfilltë. Sa i përket, ngrirjes së embrioneve të ‘tepërta’, nuk ka asnjë rrugëdalje moralisht të lejueshme.

Vëmendje të veçantë meriton fakti që DPI-ja mund të zbatohet vetëm së bashku me *teknikat e riprodhimit të asistuar* (kreu IV, nenet 15-19). Teknikat e riprodhimit mjekësor të asistuar, përveç mosrespektimit dhe mbrojtjes së jetës, paraqesin edhe dy problematika kryesore: ndajnë aspektin *bashkues nga ai riprodhues* dhe çka ia shton edhe më shumë peshën morale, ndajnë *riprodhimin nga uniteti i martesës*, sikurse ndodh me fertilizimin dhe inseminimin heterolog.

*Dëshira për të pasur fëmijë* është padyshim natyrore dhe legjitime, por nuk mund të vihet para dinjitetit të çdo jete njerëzore. Fëmija, në të vërtetë, nuk është një *objekt*, që mund të porositet, blihet e pronësohet si person-dhuratë. Në këtë këndvështrim, pretendimi i së *drejtës* për të pasur fëmijë, mohon pikërisht të drejtën e tij për t’u respektuar në dinjitetin e vet.

Do të ishte e udhës, nga ana tjetër, të flitej për të *drejtën e fëmijës*: të drejtën e tij që të lindë si fryt i dashurisë; të drejtën e shëndetit, domethënë që teknikat e fekondimit artificial të mos përdoren për qëllim selektiv (krahaso neni 24, pika 1, a); të drejtën që të njohë origjinën e prindërve të vet biologjikë, edhe pse kjo gjë hyn në konflikt me të drejtën e privatësisë dhe konfidencialitetit (krahaso neni 4, pika 1, c); të drejtën për të dy prindërit dhe familje, gjë që kundërshton të drejtën që përdoruesi i këtyre teknikave të jetë *gruaja pa partner* (kreu IV, neni 15, pika 3). Në rastin e fundit, mohohet rëndësia e figurës së babait dhe rolit të familjes. Pohohet nevoja për dhuruesin mashkull, por jo për prindin baba.

Një aspekt shumë i rëndësishëm është *impakti afektiv* dhe *kriza e identitetit*, që shkakton te fëmija surrogacia.





Lidhur me “nënë surrogate”, bie ndesh në çfarëdo mënyre me dinjitetin themelor të çdo qenieje njerëzore dhe të drejtën e saj për t’u njohur gjithmonë për atë që është në vetvete dhe kurrë si mjet për një tjetër (krahaso *Dignitas infinita*, 50). A mund të përdoret një *person* (nëna surrogate) si *mjet* për shëndetin seksual e riprodhues të një personi tjetër? A nuk kanë të gjithë njerëzit të drejta të barabarta? Këto të drejta mohohen haptazi, në kundërshtim edhe me Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut, ku pohohet se: «*Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta*» (Neni 1).

### **Dimensioni personal e social i shëndetit seksual e riprodhues**

Shëndeti seksual (krahaso Neni 3, pika 1,) nuk mund të reduktohet në sferën fizike të strukturës gjenitale, e as në aspektet më intime të jetës personale. Njeriu është i thirrur për në dashuri si shpirt i mishëruar, pra shpirt dhe trup në unitetin e personit. Nga kjo pikëpamje, projektligji, sado që flet për shëndetin riprodhues, duke e lidhur me mirëqenien fizike, mendore dhe sociale, në realitet e zhvesh atë plotësisht nga konteksti personal e social: mitrën mund ta japësh me qira, mund t’ia dëmtosh asaj përgjithmonë funksionin, mund të përdoret trupi në marrëdhënie seksuale pa angazhim personal, mund të shesësh qelizat riprodhuese etj. Të gjitha këto futen nën çadrën e *shëndetit* seksual e riprodhues me justifikimin se individi ka të drejtën e vetëpërcaktimit, sikur efektet e veprimeve të tij të ngeleshin të izoluar vetëm në sferën private, kur në fakt, nuk ekziston asnjë veprim që nuk ka, direkt apo indirekt, një impakt personal-ndërpersonal-social.

**Lidhur me sterilizimin e parashikuar në projektligj natyrshëm lind pyetja:** Cili është raporti që ka njeriu përkundrejt materialit riprodhues të tij? A mund ta përdorin materialin gjenetik, të cilin e posedon në mënyrë të pakontrolluar, si në rastin e sterilizimit? Ka një ngjashmëri midis fuqisë së njeriut për të menduar dhe të shprehurit të mendimeve të tij pa ndonjë pengesë apo kufizim? A mund të shprehin fuqinë e tij menduese njeriu pa patur pengesa? Sigurisht që jo. Sot janë dënuar persona të ndryshëm pasi keqpërdorën fuqinë e tyre menduese, duke shprehur mendime të konsideruara ekstreme. Po kur njeriu keqpërdor materialin gjenetik, a konsiderohet dhe a duhet konsideruar veprim ekstrem?

Lejohet sterilizimi apo dhe aborti kur rrezikohet jeta e nënës. Pyetja që shtrohet është: a mund të bëhet një mjek, apo një komision mjekësh përcaktues i jetës njerëzore: A i tejkalon kjo kompetencat dhe deontologjinë mjekësore? Ndërkohë kemi raste kur mjeku ka kërkuar me ngulm ndërprerjen e shtatzënisë, por kjo është refuzuar nga nëna dhe kanë jetuar të dy, dhe nëna dhe fëmija. Shembull që refuzon pjesërisht mendimin, apo veprimin e mjekut. Në këtë rast kemi sterilizim, apo dhe ndërprerje të detyruar të shtatzënisë.

### **Lidhur me abortin përmendur si “ndërprerja e shtatzënisë”**

Në rastin e abortit, vërehet përhapja e një terminologjie të paqartë, si ajo e “ndërprerjes së shtatzënisë”, që përdor edhe projektligji, e cila tenton të fshehtë natyrën e vërtetë të saj dhe të zbusë peshën e rëndë që ka në opinionin publik. “Mbase vetë ky fenomen gjuhësor - kujton *Evangelium vitae* - është një simptomë e një problemi të ndërgjegjeve. Por asnjë fjalë nuk mund



ta ndryshojë realitetin e gjërave: aborti i kryer me dashje është vrasja e vullnetshme dhe e drejtpërdrejtë e një qenieje njerëzore në fazën fillestare të ekzistencës së saj, që përfshin momentin e ngjizjes deri në lindje” (58).

*Projektligji shprehet që në fillim për ndërprerjen vullnetare e shtatzënisë, duke mos kërkuar arsye. Lind pyetja: Cilat janë disa arsye, që një veprim të një gruaje shtatzënë ta konsiderojmë vullnetar dhe jo të tillë? Flasim për autonominë (lirinë e gruas), por kush kujdeset dhe mbron autonominë e foshnjës, që do lindë dhe është në një zhvillim të vazhdueshëm, pavarësisht stadi të zhvillimit (paraembrion, embrion, fetus),? Pozicionohemi kundër ndërprerjes vullnetare të shtatzënisë, apo kundër çdo ndërprerje të shtatzënisë?*

Në thelb, ligjet janë një dhënie-marrje midis palëve. Nëse ne shkojmë me lëshime do të thotë që komunikimin nuk e fillojmë nga pika maksimale, por diku më poshtë. D.m.th. nëse ne flasim vetëm për ndërprerjen vullnetare kemi humbur pikë në dialog, nëse do na thërresin për dialog.

### **Lidhur me Teknikat e riprodhimit të asistuar**

- Në raportet e riprodhimit artificial *in vitro* janë dy komponente thelbësore: materiali gjenetik dhe fëmija që do të lindë. I pari, në rastin e nënës beqare, sipas këtij ligji konsiderohet një mall tregu. Nga ana tjetër, fëmija privohet nga përkujdesja atërore që në zanafillë. A është kjo një shkelje e të drejtës së fëmijës për ta larguar dhe parajgykuar babain, i cili në realitet është prezent nëpërmjet materialit gjenetik? Sa mund të ndikojë mungesa, jo për shkaqe natyrore, e babait në rritjen dhe edukimin e fëmijës? A është një shkelje e të drejtës së fëmijës? Ndërkohë që Kodi i Familjes në Nenin 5 shprehet që fëmija duhet të rritet në një mjedis familjar. Çfarë nënkupton mjedis familjar? Mos ndoshta në këtë mënyrë kemi bashkim të dy gjinive në një person të vetëm, tek nëna?

### **Lidhur me Përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar**

Në rastin e përdoruesit e teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar kemi tre komponentë: materiali gjenetik, huazimi i mitrës dhe fëmija. Përveç konsiderimit të materialit gjenetik shtrohen disa paqartësi: Neni 19, pika 2, si dhe Neni 22 flasin për pamundësinë e lindjes së fëmijës.. Përveç problemit të mitrës (uterus), gruaja mund të ketë dhe pamundësinë e materialit gjenetik (mungesa e vezëve). Atëherë materiali gjenetik huazohet nga një grua tjetër, pasi sipas pikës 2 të Nenit 22 përdoret fjala *infertile* dhe pika 3 e po këtij neni shprehet se gruaja nuk mund të përdorë vezët e saj. Në këtë rast kemi tre nëna, porositësja, mbartësja dhe dhuruesja e materialit gjenetik (vezëve). Si do zhvillohet fëmija brenda këtij kompleksi faktorësh? Në këtë rast kush e mbron të drejtën e fëmijës, që lind pa baba dhe ka dy, apo tre nëna të konsideruara?

Si përfundim, projektligji në fjalë nuk është problematik vetëm për efektet e menjëhershme që shkaktojnë praktikatat e teknikave të propozuara aty përkundrejt jetës njerëzore. E vërteta është se ligji (ky projektligj), me kalim e kohës, krijon një stil jete, një kulturë (vdekjeje), një mendësi, që e mbyt përgjegjshmërinë në marrëdhëniet ndërpersonale, dhe u bën vend ideologjive e sistemeve, që nuk përputhen me të vërtetën e dinjitetit njerëzor – teknokracia, trans-humanizmi etj..



Krahas argumenteve të mësipërme, shtojmë se pozicionimin e Parlamentit Evropian i miratuar në leximin e parë më 23 prill 2024 me qëllim miratimin e Direktivës (BE) 2024/... të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, që ndryshon:

Direktivën 2011/36/BE për parandalimin dhe shtypjen e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtja e viktimave, ndryshimet në Direktivën 2011/36/BE Direktiva 2011/36/BE, i cili ndalon shfrytëzimin dhe zëvendësimin mëmësisë surrogato, martesën e detyruar ose birësimin ilegal, të cilat mund të përfshihet tashmë në sferën e krimeve të lidhura me trafikimin e qenieve njerëzore siç përcaktohet në Direktivën 2011/36/BE, në masën që plotësohen të gjitha kriteret që përbëjnë këto krime. Kjo Direktivë e vë theksin gjithashtu tek ata që ata i detyrojnë ose mashtrojnë gratë, që të veprojnë si nëna surrogate.

#### IV. ASPEKTI TEOLOGJIK

Në këtë aspekt krahas mendimit shoqëror dhe etik përfshihet në to edhe mendimi teologjik. Kjo përfshirje lidhet me faktin se mendimi teologjik është zhvilluar dhe zhvillohet brenda dukurive sociale dhe të cilat kanë një shtrat etik, i cili është frymëzuar prej mendimit teologjik. Nisur nga koncepti teologjik shprehemi se:

- Ne theksojmë shenjtërinë e padiskutueshme të jetës njerëzore. Nuk ka dyshim, se një jetë unike njerëzore fillon dhe është një unitet trup-shpirt, që prej konceptimit të saj. Ne besojmë se njerëzimi, që fillon në ngjizje nuk është i rastësishëm dhe jeta e tij ka vlerë, ndonëse nuk është ende i aftë për vendimet, emocionet dhe veprimet e pavarura, që zakonisht lidhen me të qenit person.
- Çdo jetë e ka burimin dhe vlerësohet pafundësisht nga Perëndia dhe duhet të vlerësohet edhe nga njeriu.
- Trupi i njeriut dhe çdo pjesë përbërëse e tij është e shenjtë. Ndërhyrjet e panatyrshme të njeriut ndryshojnë qëllimin dhe arsyen fillestare të krijimit të njeriut.
- Sterilizimi është një veprim i dhunshëm kundër fuqisë jetësore të njeriut, duke filluar nga faza e parafekondimit.
- Jurisprudenca teologjike e krishterë dhe islame, në raste domosdoshmërie, lejojnë praktikën *in vitro* brenda disa kriterëve të caktuar. Për sa kohë që do të këtë hapësira që nuk bien ndesh me frymën e fesë, feja do të jetë pro mundësive të reja për të mundësuar jetë të reja dhe për të mbrojtur atë.
- Përdorimit të teknikave të riprodhimit të asistuar dhe mëmësisë surrogate është cënimi i sigurisë së mëmësisë.
- Kjo praktikë bie ndesh me dinjitetin që Zoti i ka dhënë njeriut. Ky dinjitet ruhet sidomos duke respektuar njeriun nga aspekti i tij fizik. Nisur nga kjo një grua nuk ka të drejtë të japë me qira organet e saj të trupit.
- Në tërësi bëhet fjalë për shkelje të normave të fesë, privatësisë, martesës, mbrojtjes së pasardhësve dhe personalitetit, sepse cenon disa parime thelbësore në lidhje me mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të njeriut, si dhe dinjitetin njerëzor.
- Kërcënimi i dinjitetit të gruas, si dhe i fëmijës janë probleme esenciale në praktikën e surrogacisë. Gruaja, nga nënë që lidhet me trup dhe me shpirt me qenien që mbart në



trup, kthehet në një mjet, që ngarkon e shkarkon krijesa. - Së dyti, fëmija për të cilin është marrë një vendim për t'u mbartur nga një grua që nuk është nëna e tij, përbën një metodë jashtë normalitetit njerëzor, proces i cili mund të jetë i papranueshëm për vetë fëmijën. Në këtë rast ai është vënë në një situatë pa zgjidhje, e cila mund t'i shkaktojë atij pasoja të rënda psikologjike. Sipas fesë islame dhe të krishterë askush nuk ka të drejtë t'i shkaktojë dikujt tjetër të tilla situata.

- Feja pozicionohet kundër praktikës së mëmësisë surrogate, nëpërmjet të cilës fëmija, me një dinjitet të pafund, kthehet thjesht në një objekt.
- Praktika e mëmësisë surrogate dhuron para së gjithash dinjitetin e fëmijës. Çdo fëmijë në fakt nga momenti i ngjizjes, i lindjes e më pas i rritjes, si djalë apo vajzë, duke u rritur, zotëron një dinjitet të paprekshëm, që shprehet qartësisht edhe pse në mënyrë të veçantë e të dallueshme në çdo fazë të jetës. Pranimi i dinjitetit të personit njerëzor sjell veç kësaj edhe dinjitetin e bashkimit bashkëshortor dhe të prokrijimit njerëzor në të gjitha dimensionet e tyre. Praktika e mëmësisë surrogate dhuron në të njëjtën kohë dinjitetin e vetë gruas që detyrohet ta bëjë ose vendos lirisht ta bëjë. Me një praktikë të tillë, gruaja largohet nga fëmija, që rritet brenda saj dhe bëhet një mjet i thjeshtë, që ka si qëllim fitimin dhe dëshirën arbitrare të dikujt tjetër.
- Zëvendësimi nuk është i lejuar në aspektin teologjik është se kjo praktikë përfshin konfuzionin e prejardhjes dhe i hap rrugën mundësisë së tradhtisë bashkëshortore.
- Edhe pse ka disa juristë që janë të mendimit se shtatzënia që nuk ka mbushur ende dyzet ditë mund të ndërpritet, shumica e dijetarëve islamë dhe të krishterë, besojnë se aborti është në kundërshtim me besimin fetar. Ndërprerja e shtatzënisë (abortit) për ndonjë arsye tjetër përveç shpëtimit të jetës së nënës është e ndaluar dhe konsiderohet vrasje.

## **V. MENDIME PËR PROJEKTLIGJIN PËR “SHËNDETIN SEKSUAL DHE RIPRODHUES”:**

- Të parashikohet me ligj ndalimi i abortit selektiv me bazë gjinore.
- Të mosparashikohet në projektligj: Lejimi i abortit me fetus 14 javësh edhe nga vajza nën 18 vjeç pa miratimin e prindërve.
- Të hiqet koncepti i mundësisë së FIV të një gruaje të vetme, pavarësisht gjendjes civile, që ajo ka (sepse në këtë mënyrë lejon rritjen e këtij fëmije nga dy persona “çift” të së njëjtës gjini).
- Ky projektligj cenon institucionin e familjes, krijuar që në zanafillë nga burri dhe gruaja, nga të cilët vijnë në jetë fëmijët.
- Cenon dinjitetin e gruas “nënës” dhe fëmijës, duke mosrespektuar jetën, e cila është dhuratë dhe bekim nga Zoti.
- Për arsye, rrethana dhe shkaqe të ndryshme, krijon precedent të rrezikshëm për shoqërinë tonë në të ardhmen, duke i hapur rrugë abuzimeve me nënat surrogate, por edhe të ardhmes së fëmijëve, që vijnë në jetë nga kjo metodë.
- Nga studimet dhe statistikat e bëra nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) mbi varfërinë, rezulton se, 770 milion njerëz në botë jetojnë në varfëri ekstreme. Po ashtu, edhe sipas UNICEF, 330 milion fëmijë në botë jetojnë në varfëri ekstreme, nga ku Shqipëria nuk është e



përrjashtuar nga një ekonomi e dobët, ku për shkak të kushteve sociale, arsimore dhe ekonomike, shumë gra mund të bien pre dhe të zgjedhin të jenë nëna surrogate, duke e kthyer në tregti dhe duke e parë si mjet fitimi, gjë e cila çon në shkelje të të drejtave të gruas, etikës dhe dinjitetit njerëzor.

- Një rrezik tjetër është trafikimi i qenieve njerëzore, ku fëmijë, të cilët vijnë në jetë nga kjo metodë mund të porositen nga grupe kriminale të trafikut.
- Bota dhe shoqëria mbarënjëzore sot, po përballen me trafikimin e qenieve njerëzore, trafikim organesh, shfrytëzim prostitucioni, abuzime seksuale pedofilie dhe shfrytëzimi në rrugë i fëmijëve për përfitime ekonomike. Surrogacia e rrit rrezikun e këtyre problematikave.
- Mungesa e garantimit të jetës dhe mbrojtjes së fëmijës, i cili lind nga një nënë surrogate.
- Traumata psiko-emocionale të fëmijëve kur të përballen me realitetin e ngjizjes së tyre, kur të jenë në - moshë madhore.
- Ligji bazohet mbi konceptin e drejtësisë, por anashkalohet drejtësia për foshnjën që do lindë apo për atë që nuk i jepet mundësia të vijë në jetë.
- Projektligji fokusohet tek zgjidhja e një problemi, por nuk merr në konsideratë pasojat e mëpasshme.
- Lehtësirat e krijuara për ndërprerjen e shtatzënisë e kthejnë me lehtësi shoqërinë në një vrasëse të qenies njerëzore ose heqëse - të së drejtës për të jetuar.
- Ndërprerja e shtatzënisë bëhet me dëshirën e shprehur nga gruaja, por jo nga bashkëshorti i saj.
- Ndërkohë që vajza konsiderohet në moshën 18 vjeç e ndërgjegjshme dhe e pjekur për të marrë vendime, nuk ndodh e njëjta gjë me abortin. Në këtë rast ajo e merr vendimin në moshën 16 vjeç.
- Në rastin e një sëmundje, jo vetëm nëna, por dhe mjeku merr të drejtën për të përcaktuar kush do të rrojë, nëna apo foshnja. Pra, mjeku përveç të drejtës mjekësore merr përsipër dhe rolin e përcaktuesit të jetës njerëzore.
- Dhurimi ose asgjësimi i vezëve të pafekunduara dhe embrioneve mund të bëhen sipas ligjit me shumë lehtësi. Kjo formë krijon biznesin e vezëve dhe embrioneve, duke e kthyer procesin në biznes dhe larg natyrës mjekësore. Në këtë mënyrë nëpërkëmbet veçoria e materialit gjenetik dhe roli thelbësor që ai ka.
- Numri i dhurimit të materialit gjenetik (vezë apo spermatozoidë) nuk duhet të kalojë numrin pesë. Por nëse këto materiale gjenetike përdoren në një ambient të përafërt atëherë do kemi vëllezër dhe motra, të cilat nuk do ta njohin njëri-tjetrin dhe mund të krijojnë marrëdhënie intime në të ardhmen, fenomen ky, i cili çon në incest.
- Lejimi i ngjizjes së fëmijëve për nënat beqare është një problem i rëndësishëm shoqëror. Ai fillon me një material gjenetik të dhuruar dhe vazhdon që në gjenezë rritja e fëmijës pa baba, gjë e cila kjo nuk ndodh për shkak të një fatkeqësie natyrore (vdekja), por nga dëshira e gruas. Është një fenomen i cili zhvillohet mbi egoizmin e njeriut dhe nuk merr në konsideratë dëshirën e fëmijës për t'u rritur pa prezencën e babait.